



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 13, pika 13.7 dhe nenit 19 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikim hapësinor, të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-106, për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinorë 2003/14 ("Gazeta zyrtare Republikës së Kosovës" nr. 42/2008), të nenit 17, shkronja **b** dhe nenit 40, pika 40.2 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), të nenit 15, pika 15.1, shkronja **b** dhe të nenit 33, pika 33.2, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.07.2011, merr këtë

V E N D I M
PËR SHQYRTIM PUBLIK TË PROPOZIMPLANIT RREGULLUES "ZONA EKONOMIKE" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues "ZONA EKONOMIKE" në Prishtinë. Propozimplanit, nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Shqyrtimi publik i Propozimplanit rregullues, sipas këtij vendimi, zgjat 30 ditë duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Prishtinës. Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit, sipas këtij vendimi, do ta bëjë Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Propozimplanit, nga neni 1 i këtij vendimi, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit do të kryejë veprime të parapara ligjore për finalizimin e këtij plani, në mënyrë që ai t'i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës. Organet tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara me Statut, për zbatimin e këtij plani.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 35-2102, më 16.09.2011

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.